

KONTRATË PËR SHITJEN E KUOTËS

Sot më datë 06.11.2018, në Tiranë midis palëve të mëposhtme:

Z. Gëzim Arkaxhiu, shtetas shqiptar, lindur më 23.03.1979, në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 024453856 dhe numër personal H90323148P, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, në cilësinë e ortakut të vetëm të Shoqërisë "Retail Park" Sh.p.k. (në vijim referohet si "**Shitësi**")

dhe

Z. Klenti Budina, shtetas shqiptar, lindur më datë 19.01.1976 në Tiranë, me numër personal H60119114S, banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar. (në vijim referohet si "**Blerësi**")

Duke qenë se:

- A. Shitësi është pronar i një kuote që përfaqëson **100% (njëqind përqind) të kapitalit të regjistruar** të shoqërisë **RETAIL PARK SHPK**, themeluar sipas legjislacionit shqiptar më **13/03/2017**, me numër **NUIS L71515042Q** dhe seli në adresën: Njesia Bashkiake nr 6, Rruga e Kavajes, ish Misto Mame, prane godines Pillus ("Shoqëria").
- B. Blerësi dëshiron të blejë të gjithë Kuotën e Shitësit që përfaqëson **100% (njëqind përqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë ("Kuota në Shitje")** dhe Shitësi dëshiron të shesë tek Blerësi Kuotën në Shitje sipas kushteve dhe detyrimeve të kësaj Kontrate;

Palët në këtë kontratë ("Kontrata") bien dakord si më poshtë:

- 1. **OBJEKTI I KONTRATËS**
 - 1.1 Objekt i kësaj kontrate është shitja dhe transferimi i Kuotës në Shitje në pronësi të Shitësit në Shoqëri nga Shitësi tek Blerësi në përputhje me parashikimet e mëposhtme.
 - 1.2 Pronësia e Kuotës në Shitje kalon tek Blerësi në përputhje me kushtet dhe detyrimet e kësaj Kontrate dhe Kuota në Shitje do të shitet dhe blihet së bashku me të drejtat dhe përfitimet e lidhura me to.
 - 1.3 Me kalimin e pronësisë së Kuotës në Shitje në pronësi të Blerësi, Blerësi do të zotërojë një Kuotë të Shoqërisë që përbën **100% (njëqind përqind) të kapitalit të regjistruar të saj**.
- 2. **CMIMI I BLERJES SË KUOTËS, MËNYRA E PAGESËS DHE KALIMI I PRONËSISË**
 - 2.1 Cmimi i Kuotës në Shitje që do të paguhet nga Blerësi është **100 LEK (njëqind lekë) ("Cmimi i Blerjes")**.
 - 2.2 Blerësi do t'i paguajë Çmimin e Blerjes Shitësit brenda një jave nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate.
 - 2.3 Pagesa e Çmimit të Blerjes do të kryhet me anë të transferimit të shumës përkatëse në llogarinë bankare të Shitësit, me të dhënat e mëposhtme:
EMËR: Gëzim Arkaxhiu
NR. LLOGARIE: 0190551315
BANKA : Raiffeisen Bank Sh.a
KODI SWIFT: SGSBALTX
IBAN NË LEK: AL51202110370000000190551315
 - 2.4 Pronësia mbi Kuotën në Shitje do të kalojë në momentin e nënshkrimit të kësaj Kontrate.

3. DEKLARIMET E GARANCITË E SHITËSIT

- 3.1** Shitësi deklaron dhe garanton ndaj Blerësit dhe në favor të tij, se secila nga garancitë dhe deklaratimet ("Garancitë e Shitësit") në vijim janë të vërteta dhe të sakta si në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate ashtu dhe në datën e kalimit të pronësisë mbi Kuotën në Shitje sipas Nenit 1.1.
- 3.3** Shitësi është një individ me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- 3.4** Shitësi gëzon të gjithë të drejtat dhe aftësinë ligjore për të lidhur këtë Kontrate dhe për të përfunduar transaksionet për të cilat është rënë dakord në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate.
- 3.4** Kuota në Shitje në pronësi të Shitësit përfaqëson 100% (njëqind përqind) të kapitalit të Shoqërisë.
- 3.5** Shitësi garanton që Kuota në Shitje sipas kësaj Kontrate nuk është rënduar me barra të ndryshme ligjore (barrë siguruese/peng apo ndonjë formë tjetër barrë ligjore) në favor të palëve të treta, private apo shtetërore.

4. DEKLARIMET E GARANCITË E BLERËSIT

- 4.1** Blerësi, paraqet dhe garanton ndaj Shitësit dhe në favor të tij, se secila nga garancitë dhe deklaratimet në vijim janë të vërteta dhe të sakta në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate dhe në datën e transferimit të pronësisë mbi Kuotën në Shitje.
- 4.2** Blerësi është një individ me zotësi të plotë juridike për të vepruar.;
- 4.3** Blerësi gëzon të gjithë të drejtat dhe aftësinë ligjore për të lidhur këtë Kontrate dhe për të përfunduar transaksionet për të cilat është rënë dakord në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate.
- 4.4** Blerësi pranon se përpara nënshkrimit të Kontratës i është dhënë mundësi e plotë për të marrë informacionin e nevojshëm në lidhje me Shoqërinë në mënyrë që të marrë një vendim të informuar në lidhje me këtë transaksion.

5. DETYRIMET E BLERËSIT

- 5.1** Blerësi detyrohet që të kryejë pagesën e Cmimit të Blerjes sipas mënyrës së përcaktuar në Kontratë.

6. DEMSHPERBLIMI

- 6.1** Në rast se Cmimi i Blerjes nuk kreditohet në llogarinë e Shitësit sipas parashikimeve të nenit 2.2, kjo Kontratë konsiderohet e zgjidhur automatikisht dhe nuk krijon asnjë pasojë ligjore për palët të cilat do të kthehen në gjendjen e mëparshme.
- 6.2** Në rast se Blerësi nuk përmbush detyrimet e tij në këtë Kontratë dhe/ose shkel deklaratimet dhe garancitë e dhëna në Nenin 4 dhe 5, atëherë Shitësi ka të drejtë të zgjidhë Kontratë dhe të kërkojë cdo humbje apo dëmshpërblim tjetër si pasojë e mospërmbushjeve apo shkeljeve të Blerësit.
- 6.3** Në rast se Shitësi nuk përmbush detyrimet e tij në këtë Kontratë dhe/ose shkel deklaratimet dhe garancitë e dhëna në Nenin 3, atëherë Blerësi ka të drejtë të zgjidhë Kontratë dhe të kërkojë cdo humbje apo dëmshpërblim tjetër si pasojë e mospërmbushjeve apo shkeljeve të Shitesit.

7. KOSTOT

- 7.1** Secila Palë merr përsipër kostot e saj lidhur me negociatën, mbylljen dhe nënshkrimin e dokumentave të detyrueshme ligjërishit ose sipas kësaj Kontrate.
- 7.2** Cdo tarifë, taksë ose tatim që duhet paguar nëse ka të tillë si rezultat i nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe i kalimit të Kuotës në Shitje, merret përsipër nga pala që është e detyruar me ligj dhe, në rast se ligji nuk përcakton se kujt pale i ngarkohen, ato ndahen në mënyrë të barabartë midis palëve.

8. LIGJI I ZBATUESHEM

- 8.1** Kjo Kontratë dhe marrëdhëniet midis Palëve do të rregullohen nga legjislacioni shqiptar, dhe do të interpretohet në përputhje me ligjet shqiptare.



9. JURIDIKSIONI

9.1 Cdo mosmarreveshje që lind nga ose në lidhje me këtë Kontratë përsa i përket zbatueshmërisë ose vlefshmërisë do të zgjidhet përfundimisht nga gjykata kompetente shqiptare.

10. TË NDRYSHME DHE SHITESA

10.1 Asnjë ndryshim, shtesë, ose tjetërsim i kësaj Kontrate nuk do të jetë e vlefshme nëse nuk është me shkrim në një dokument të vetëm të nënshkruar nga ose për llogari të Palëve.

11.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, të drejtat dhe detyrimet sipas kësaj Kontrate do t'u kalojnë, në rastet e parashikuara nga ligji apo kjo kontratë, të gjithë pasuesve, zëvendësuesve ose trashëgimtareve të palëve.


10.3 Në rast se në çdo kohë ndonjë prej dispozitave të kësaj Kontrate është ose bëhet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme, atëherë kjo dispozitë do të konsiderohet e pavarur nga kjo Kontratë dhe nëse është e mundur do të zëvendësohet nga një dispozitë e vlefshme, e cila do të shprehë, sa më afër të jetë e mundur, qëllimin e Palëve sipas kësaj Kontrate dhe aty ku është e mundur nuk do ndikojë ose dëmtojë vlefshmërinë apo zbatueshmërinë e ndonjë dispozite tjetër të Kontratës.

11. GJUHA, KOPJET E KONTRATËS DHE HYRJA NË FUQI

11.1 Kjo Kontratë hartohet në 2 kopje në gjuhën shqipe, secila prej tyre do të konsiderohet origjinale, por të gjitha bashkë do të përbëjnë një dhe të njëjtën marrëveshje.

PALET

SHITËSI


Gëzim Arkaxhiu

BLERËSI


Klenti Budina